PLANI STRATEGJIK PËR AVOKIM

Nëntor 2023 - Tetor 2025

Grupi Hëna

Autorsia: HANDIKOS

Ky publikim është financuar nga Qeveria Suedeze me mbështetje të Save the Children. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi i saj. Qeveria Suedeze apo Save the Children jo domosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Prapavija

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë grup i rëndësishëm i shoqërisë së Kosovës, të cilët duhet të mbrohen, mbështeten dhe integrohen në mënyrë të barabartë në shoqëri. Ky është detyrim që del nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës, për t'u siguruar që ata të mos lihen të izoluar dhe të përjashtuar nga shoqëria. Kjo ndodh shpesh për shkak të mungesës së sensibilizimit dhe informacionit të mjaftueshëm në lidhje me nevojat dhe potencialet e tyre. Është e rëndësishme të kemi parasysh se çdo fëmijë, pavarësisht potencialevetë tij, ka të drejtë të jetë i lumtur, dhe i perfshire në menyre aktive në shoqëri. Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë është mungesa e infrastrukturës dhe burimeve të nevojshme për mbështetjen e tyre. Shpesh herë, shkollat dhe ambientet e tjera ku ofrohet edukim dhe arsimim, nuk janë të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke u vështirësuar atyre qasjen në arsim. Për më tepër, ekziston mungesë e burimeve, si mësimdhënës dhe profesionistët tjerë që punojnë me këtë grup të fëmijëve. Poashtu, fëmijëve me aftësi të kufizara nuk u ofrohen asistentë personalë, për t'i ndihmuar ata në jetën e përditshme.

Kjo situatë i të fëmijët me aftësi të kufizuara në një pozitë të vështirë dhe bën që ata të jenë të privuar nga shumë mundësi, të cilat i gëzojnë fëmijët e tjerë. Përmirësimi i infrastrukturës, trajnimi i pedagogëve dhe ofrimit të asistencës personale janë thelbësore për të siguruar që këta fëmijë të kenë mundësinë e një arsimimi dhe zhvillimi të plotë në shoqëri.

Gjithashtu, është e rëndësishme të investohet në trajnimin e stafit arsimor dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijëvt. Ata duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të jenë të aftë të përdorin metoda dhe teknika të përshtatshme për të përmbushur nevojat e tyre.

1. Përmbledhja

Strategjia e avokimit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara është zhvilluar nga grupi "Hëna", i cili përbëhet na anëtarë nga komuna të ndryshme të Kosovës. Strategjia

fillon me një vizion të qartë dhe një mision të fuqishëm. Në një Kosovë ku fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara shpesh ndjehen të izoluar dhe të përjashtuar, ajo ofron një vizion frymëzues: ata duhen të trajtohen si qytetarë të barabartë në shoqëri. Ajo, po ashtu ofron një mision të qartë ku Grupi Hëna do të avokojë për të drejtat e këtyre fëmijëve dhe të rinjve.

Si qëllim, grupi i ka caktuar vetes respektimin e të drejtave të këtij grupi të veçantë të fëmijëve. Arritja e këtij qëllimi do të bëhet përmes katër objektivave specifike.

1. **Rritja e pjesëmarrjes e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën publike.**
2. **Rritja e përkrahjes së institucioneve qeverisëse për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.**
3. **Ngritja e vetëdijes së shoqërisë lidhur me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.**
4. **Sigurimi i gjithëpërfshirjes në klasa të rregullta për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.**

Së pari, synojnë rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën publike. Kjo përfshin lehtësimin e qasjes së tyre në mjedise publike, si rrugë dhe objekte të qasshme. Përveç kësaj, ata do të kërkojnë edhe pajisjen e sallave sportive me mjete të përshtatshme për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe të organizohen aktivitete artistike që i inkurajojnë ata të marrin pjesë, si për shembull futboll në tavolinë, lojëra shahu, shfaqje teatrale, vizatime në sheshe publike, si dhe aktivitete tjera që do të identifikohen së bashku me secilën komunë.

Së dyti, strategjia fokusohet në rritjen e përkrahjes së institucioneve qeverisëse në nivel qendror dhe lokal për këtë grup fëmijësh dhe të rinjsh. Kjo përfshin gjithashtu ndërmarrjen e masave për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, si dhe përshtatjen e mësimit dhe kurrikulave për të përmirësuar qasjen dhe shkëmbimin e njohurive për këtë grup të veçantë të nxënësve. Kjo objektivë përfshin, po ashtu, rritjen e numrit të mësuesve mbështetës , sigurimin e asistentëve personalë, dhe rritjen e numrit të sesioneve psikologjike në shkolla për të ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i strategjisë është promovimi i ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me nevojat dhe mundësitë e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të

kufizuara, duke parandaluar diskriminimin dhe duke inkurajuar përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe arsimore. Këto masa janë të rëndësishme për të siguruar që çdo individ të ketë mundësinë për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë dhe për të kontribuar në shoqërinë në të cilën jetojnë.

Sigurimi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në klasa të rregullta është një hap i rëndësishëm drejt barazisë dhe mundësisë për të gjithë femijet. Zhvillimi i trajnimeve për mësimdhënësit dhe drejtorët është hap kyç për t'u siguruar që ata kanë njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të bërë klasat më të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin metodologji të mësimdhënies dhe menaxhimin e klasës që do të përmirësojë përvojën e këtyre femijeve.

Ky plan strategjik është një udhërrëfyes që drejton kah një e ardhme më të ndriçuar dhe më të drejtë për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në Kosovë. Anëtarët e Grupit Hëna janë të vetëdijshëm se ky është një rrugëtim i vështirë, por me një vizion të qartë dhe një përkushtim të patundur, ata do të arrijnë ndryshime në shoqëri, duke garantuar se të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilat janë të garantuara me ligj, respektohen dhe mbrohen.

2. Vlerat e Grupit Hëna

a. Vizioni

Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara trajtohen si qytetarë të barabartë në shoqëri.

b. Misioni

Avokim për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

c. Qëllimi

Të respektohen të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

d. Objektivat specifike dhe rezultatet

1. Rritja e pjesëmarrjes e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën publike.

1.1. Është lehtësuar qasja për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në rrugë dhe në objekte publike.
1.2. Janë rregulluar dhe pajisur sallat sportive me mjete adekuate për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
1.3. Janë organizuar aktivitete artistike për dhe me fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara.

2. Rritja e përkrahjes së institucioneve qeverisëse për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.

2.1. Është rritur numri i mësuesve mbështetës në shkolla.
2.2. Janë siguruar asistentë personalë për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
2.3. Është rritur numri i psikologëve në shkolla dhe numri i seancave psikologjike për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara.
2.4. Është rritur numri i terapistëve të specializuar për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare.

3. Ngritja e vetëdijes së shoqërisë lidhur me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.

3.1. Është rritur numri i aktiviteteve publike të organizuara nga vetë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
3.2. Është rritur numri i publikimeve në mediat sociale, përfshirë facebook, instagram, tiktok, snapchat, pinterest.
3.3. Është rritur kontakti me institucionet publike për fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

4. Sigurimi i gjithëpërfshirjes në klasa të rregullta për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.

4.1. Janë mbajtur trajnime me personelin arsimorë dhe drejtorë rreth aftësisë së kufizuar.
4.2. Janë krijuar dhe funksionalizuar Ekipet Vlerësuese Pedagogjike nëpër komunat e synuara.

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1. Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën publike.																
1.1. Është lehtësuar qasja për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në rrugë dhe në objekte publike.	1. Takimi me Handikos-in për këmbim të informatave.	HANDIKOS	Kryetari i grupit													
	2. Identifikimi i vendeve të paqasshme, përfshirë rrugët dhe objektet publike.		Anëtarët, raportojnë tek kryetari													
	3. Kërkesa dhe ankesa në komunë.	Drejtorati i Urbanizmit Drejtorati për Shërbime Publike	Kryetari dhe anëtarët													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	4. Organizimi i takimeve me zyrtarët komunalë.	Drejtoritë për urbanizëm dhe shërbime publike, nënkryetarët e komunës, kryetari														
1.2. Janë rregulluar dhe pajisur sallat sportive me mjete adekuate për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.	1. Identifikimi i pajisjeve nëpër salla të sporteve.	Sallat e sporteve	Grupi komunal													
	2. Dorëzimi i kërkesave dhe ankesave tek komuna për sallat që nuk kanë mjete sportive adekuate.	Drejtorati për Rini, Sport dhe Kulturë	Kryetari													
	3. Takime me zyrtarët komunalë.	Drejtorati për Sport,	Grupi komunal													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
		nënkryetari, kryetari														
1.3. Janë organizuar aktivitete artistike për dhe me fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara.	1. Organizimi i fëmijëve dhe të rinjve për të lobuar në komunë për organizim të aktiviteteve kulturore dhe rekreative me fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara.	Drejtorati për kulturë, rini dhe sport	Kryetari i grupit													
	2. Organizimi i shfaqjeve teatrale me fëmijë me aftësi të kufizuara për të dërguar mesazhe vetëdijesuese.	Drejtorati për kulturë, rini dhe sport HANDIKOS	Grupi Hëna													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2. Rritja e përkrahjes së institucioneve qeverisëse për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.																
2.1. Është rritur numri i mësuesve mbështetës në shkolla.	1. Takime me komunën për të caktuar mësues mbështetës.	Drejtorati për Arsim	Kryetari i cakton takimet, grupi merr pjesë në takim													
	2. Takime me ministrinë e arsimit për të mbështetur caktimin e mësuesve mbështetës.	Ministria e Arsimit	Kryetarët e grupeve komunale													
	3. Identifikimi i nevojave të shkollave ku ka nevojë për mësimdhënës mbështetës.	Drejtorati për Arsim	Grupi Hëna													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	4. Organizimi i protestës për të rritur numrin e mësimdhënësve mbështetës.	HANDIKOS	Grupi Hëna	Transport 140; pano 100; ushqim për pjesëmarrësit 300												
	5. Kërkesë në komunë për sigurim të asistentit personal.	Qendra për punë sociale	Kryetarët e grupeve													
	6. Njoftimi i familjeve për të aplikuar për asistent personal.	Publiku i gjerë	Grupi Hëna													
	7. Takim me ministrinë për të bërë zgjidhje për asistent personal.	Departamenti për Mirëqenie Sociale	Përfaqësuesit e grupeve komunale	Transport 120 euro												
	8. Organizimi i protestës masive për	HANDIKOS	Grupi Hëna	Transport me												

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	sigurim të asistentëve personal.			autobusë 3,000 euro												
2.2. Është rritur numri i psikologëve në shkolla dhe numri i seancave psikologjike për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara.	1. Identifikimi i shkollave që nuk kanë psikolog.	Drejorati i Arsimit; shkollat	Grupi Hëna													
	2. Kërkesë në komunë për sigurimin e psikologëve në shkolla.	Drejtorati i Arsimit	Kryetarët e grupeve													
	3. Takime me komunën për të caktuar psikolog në shkollë	Drejtorati i Arsimit	Grupi Hëna													
2.3. Është rritur numri i terapistëve të specializuar për punë me fëmijë me	1. Kërkesë në komunë për sigurimin e terapistëve në QMF.	Drejtorati për shëndetësi	Grupi Hëna													
	2. Takime me komunën për të	Drejtorati për shëndetësi	Grupi Hëna													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
aftësi të kufizuara nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare.	caktuar terapistë në QMF.															
3. Ngritja e vetëdijes së shoqërisë lidhur me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.																
3.1. Është rritur numri i aktiviteteve publike të organizuara nga vetë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.	1. Organizimi i lojërave të pingpongut.	Drejtorati për Mirëqenie Sociale	Grupi Hëna													
	2. Organizimi i notit.	Drejtorati për Mirëqenie Sociale	Grupi Hëna													
	3. Organizimi i lojërave në pikado dhe fuboll tavoline.	Drejtorati për Mirëqenie Sociale	Grupi Hëna													
	4. Organizimi i aktiviteteve muzikore / artistike	Drejtorati për Mirëqenie Sociale	Grupi Hëna													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	5. Organizimi i aktiviteteve të vizatimit në vende publike.	Drejtorati për Mirëqenie Sociale	Grupi Hëna													
	6. Takim me komunën për të organizuar aktivitet me fëmijë për shënimin e ditëve ndërkombëtare	Drejtorati për Mirëqenie Sociale; Zyra për të Drejtat e Njeriut	Kryetarët e Grupeve													
	7. Kërkesë ministrisë për organizim të kampionateve të lojërave në nivel të Kosovës.	Departamenti i Mirëqenies Sociale														
3.2. Është rritur numri i publikimeve në mediat sociale, përfshirë	1. Publikimi i aktiviteteve dhe të arriturave në mediat sociale.		Grupi Hëna													
	2. Publikimi i aktiviteteve me fëmijë në llogaritë e		Kryetarët e grupeve													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
facebook, instagram, tiktok, snapchat, pinterest.	mediave sociale të komunës.															
	3. Shpërndarja e aktiviteteve me fëmijë me aftësi të kufizuara nga llogaritë e njëri-tjetrit.		Grupi Hëna													
	4. Inçizimi i videove dhe fotografive gjatë aktiviteteve.		Grupi Hëna													
	5. Hapja e llogarive në mediat sociale veçanërisht për grupin Hëna.		Mentori i grupit													
	6. Raportimi i aktiviteteve të grupit Hëna në faqen e parë të llogarive sociale të grupit.		Mentori i grupit													
	7. Të shenjohen me # organizatat		Grupi Hëna													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	mbështetëse të grupit hëna.															
	8. Kërkesë komunës që të ftojë mediat në aktivitetet e fëmijëve me aftësi të kufizuara.		Kryetarët e grupeve													
3.3. Është rritur kontakti me institucionet publike për fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.	1. Takime të rregullta me zyrtarë publikë në komuna.	Komunat	Kryetarët e Grupeve; Grupi Hëna													
	2. Takim me kryetarin e komunës.	Kryetarët e Komunave	Kryetarët e Grupeve													
	3. Rritja e prezencës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në jetën publike vetëm dhe pa përcjellje.		Grupi Hëna													
	4. Vizita të rregullta në institucione publike (komunë, teatër, shkollë, qendër për punë		Grupi Hëna													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	sociale, muze, bibliotekë)															
	5. Organizimi i aktiviteteve sportive / artistike në hapësirat publike.		Grupi Hëna													
4. Sigurimi i gjithëpërfshirjes në klasa të rregullta për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.																
4.1. Janë mbajtur trajnime me stafin arsimor dhe drejtorë rreth aftësisë së kufizuar.	1. Takim me Drejtoratin për Arsim për paraqitjen e nevojave për trajnim të personelit arsimor për qasje dhe punë me fëmijët me aftësi të kufizuara.	Drejtorati për Arsim	Kryetarët e grupeve													
	2. Anëtarët e grupit Hëna të marrin pjesë në trajnimin e mësimdhënësve dhe të paraqesit nevojat dhe aftësitë e tyre.		Kryetarët e grupeve													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	3. Krijimi i udhëzuesit të shkurtër për punë me fëmijët me aftësi të kufizuar.		Mentori i grupit (Ermina)	Buxheti për expert për përpilim të udhëzuesit 700 euro												
	4. Takim në Ministri të Arsimit për të kërkuar trajnimin e personelit arsimor të të gjitha niveleve për qasje dhe punë me fëmijët me aftësi të kufizuara. .	MASHT, departamenti për gjithëpërfshirje	Kryetarët e grupeve (Eliza)													
4.2. Janë krijuar komisionet vlerësuese nëpër																
	1. Kërkesë në komunë për themelimin dhe funksionalizimit e	Drejtorati i Arsimit	Kryetari i grupit													

Rezultati	Aktiviteti	Institucioni i synuar	Kush	Buxheti	Kur											
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
komunat e synuara.	Ekipeve Vlerësuese Pedagogjike.															
	2. Organizimi i ligjëratave për kujdestarë të klasëve mbi qasjen dhe punën me fëmijë me aftësi të kufizuara.	Arsimtarët e shkollave	Kryetari i grupit dhe një anëtar i grupit													
	3. Vetëdijësimi i prindërve për të përkrahun fëmijët për gjithëpërfshirje në klasat e rregullta.		Grupi Hëna													